



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



**P R O C E S V E R B A L**

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **19.06.2019**, me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimi më lejoni të përshëndes, nënkyetarin **Fatmir Iska**, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.. Kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

**R E N D D I T E**

- 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Informatë e Raportit Financiar vjetor të Komunës së Rahovecit për vitin 2018 e Auditorit Kombëtar,**
- 3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës komunale,**
- 4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për raste të veçanta,**
- 5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej  $110000\text{ m}^2$  në Rahovec,**
- 6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej  $42099\text{ m}^2$  në Rahovec,**
- 7. Informatë nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport për objektet e trashëgimisë kulturore – historike të Komunës së Rahovecit,**
- 8. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit,**
- 9. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit,**
- 10. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit për vitin 2019,**
- 11. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** - A ka dikush të shtoj diçka rreth procesverbalit, nëse nuk ka atëherë e qes në votim Procesverbalin nga Mbledhja e Kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

### **2. Informatë e Raportit Financiar vjetor të Komunës së Rahovecit për vitin 2018 e Auditorit Kombëtar.**

**Afrim Limani** – Drejtori Limani përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, dhe i prezantoi informatën e auditorit të përgjithshëm në pika të shkurta anëtarëve të KPF-së, ku ceku se pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2018 janë kualifikuar si pozitive. Dhe me këtë drejtori Limani tha se komuna e Rahovecit ka krijuar mundësinë që të thithë grande si nga qeveria e Republikës së Kosovës ashtu edhe nga ndonjë donator i jashtëm, po ashtu kjo është një imazh i mirë për komunën e Rahovecit.

**Florida Bajraktari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në faqe nr.13 ku ceket raporti financiar për vitin 2018 na keni raportuar se buxheti për këtë vite është shpenzuar rreth 97%, kurse auditori i përgjithshëm cekë se buxheti i përgjithshëm është shpenzuar 91.5%, mendoj se diçka nuk është duke u përputhur këtu. Pastaj tek çështja A6 tek gjetjet, ceket se ka dobësi edhe në menaxhimin e pagesave për investime, sepse në dy raste komuna i ka kryer pagesat ende pa u pranuar pranimi teknik i punëve.

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ky raporte lirishtë mundem të them që është një raporte mjaftë i gjerë dhe mjaftë gjithëpërfshirës, jam duke parë që auditimi është bërë në tre hallka, në pasqyrat financiare vjetore, menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe në fund zbatimi i rekomandimeve. Nëse i shikojmë të tre këto hallka ajo që është gjetur në auditim fletë për mjaftë të gjetura të parregullta në të tri hallkat. Duke filluar nga pasqyrat financiare vjetore, drejtori i ceku disa arsyeshmëri për këto të pagjetura si llogaritjet gabim ose mos barazimi që është bërë tatimi në pronë në vlerën prej 53,515.00 €. Pastaj obligimet e papaguara nga viti 2017, që nuk janë përfshirë në vitin 2018 e që është një vlerë mjaftë e madhe. Auditori për të gjitha këto thotë se kur është bërë auditimi, komuna nuk ka arritur që të na ofroj dëshmi për të arsyetuar diferençën e paraqitur, nuk e di pse janë bërë këto gabime, nuk është dashur të bëhen kësot lloje gabime. Pastaj tek shpenzimet në vlerë prej 137,982.00 € janë keq klasifikuar ose sipas tyre është bërë realizimi gabimisht, pra është bërë një lëvizje nga një kod i planifikuar në kodin tjetër. Janë shpenzuar afro 100,000.00 € nga investimet kapitale në shërbime dhe mallra, pastaj një pjesë e të hollave nga kodi i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve është shpenzuar për paga dhe mëditje dhe subvencione, edhe pse buxheti është aprovuar në kuvend. Pra janë bërë disa shkelje buxhetore, ligjore ose keq menaxhime të buxhetit, drejtori i dha disa sqarime por ne e dimë se këto janë të papranueshme sepse kur buxheti aprovohet në kuvend, kode nuk duhet të lëvizin nga një kod në kodin tjetër. Tek menaxhimi financiar dhe kontrolli nëse e bëjmë një kahasim, burimet e fondevë buxhetore dhe shpenzimet e fondevë buxhetore, mendoj se është një element shumë me rëndësi shpenzimet që i bënë komuna për qëllime të caktuara, nëse ato përputhen me burime atëherë ato vlerësohet performanca e komunës. Ne këtu jemi duke parë një performancë jo të mirë të komunës, në aspektin e përgjithshëm komuna ka shpenzuar, pra niveli i realizimit ka qenë 91.5%, por nëse i referohemi tabelës së shpenzimeve të fondevë sipas kategorive ekonomike, na del që mallrat dhe shërbimet janë realizuar vetëm 62%, kurse për investime kapitale realizimi ka qenë vetëm 55%. Mendoj se kjo është një perfromancë jo e mirë, po ashtu ceket se dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimin, dhe shumica e shpenzimeve dhe realizimeve është bërë në tre mujorin e fundit të vitit, mendoj se këtu vlerësohet puna dhe cilësia e qeverisë, pra dinamika e shpenzimeve duhet të jetë gjatë gjithë vitit e jo vetëm ka fundi i vitit. Ka edhe mjaftë të gjetura të tjera edhe tek pjesa e punësimeve që janë bërë sipas një marrëveshje e cila quhet marrëveshje për shërbime të veçanta, ku janë tejkaluar kompetencat ligjore, sepse sipas ligjit punësimet e përkohshme munden të bëhen deri në 6 muaj, kurse këtu ceket se ju është vazhduar më shumë. Po ashtu edhe për pjesën e prokurimit ka mjaftë vërejtje, ku cekën dobësitë sistematike në menaxhimin e pagesave për investime, ku janë nënshkruar kontratat pa pasur buxhet të zotuar, ku sipas ligjit kjo nuk lejohet. Pastaj në

faqe nr. 26 është pjesa e pagesave sipas vendimeve gjyqësore, ku komuna është detyruar të paguaj gjykatës shtesë buxhet me shumën prej 4,360.00 €, për arsyet e vonesave në pagimin e pagave jubilare për zyrtarë në rastin e pensionimit.. kjo duhet të sqarohet, kryetari vetë më parë e ka cekur se nuk do të ketë më kësot lloj problemesh, të pensionuarit nuk do të detyrohen që përmes gjykatave të i marrin pensionet e tyre që ju takojnë me ligj, por do të shkojnë në mënyrë të rregullt, sepse nëse shkojnë përmes gjykatës ata përsëri e fitojnë rastin dhe i marrin paret, kurse komuna i paguan edhe shpenzimet e gjykatës. Për vetë faktin që ne e shohim se janë diku rrëth 21 rekomandime, kjo fletë se me të vërtet ka çka të përmirësoset, pra ka vërejtje të shumta rrëth performancës, dhe kjo neve na bënë që të dyshojmë sepse nëse thuhet se Rahoveci ka pasur një performancë shumë të mirë për këtë vit, atëherë si është e mundur që të gjenden të gjitha këto gabime. Dhe ky raporte nuk fletë për një performancë të mirë, mendoj se në të ardhmen këto gjëra nuk duhet të përsëriten, Për më shumë ne do ta shqyrtojmë këtë raporte në mbledhje të kuvendit.

**Fahrije Lushi Morina** – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, do i përmendi disa nga karakteristikat ose të gjeturat të cilat brenda këtij reporti të auditorit kombëtar janë të përcaktuara mirë, dhe thjeshtë flasin për ato ngecjet ose çështjet të cilat duhet patjetër kryetari ose qeverisja komunale të ndërmarr masa për përmirësimin e tyre. Ajo që më ka rënë më së shumti në sy është se auditori kombëtar ka kërkuar që kryetari të ketë parasysh dhe të merë në menaxhim pak më të sigurte njësinë e auditimit të brendshëm, thuhet se brenda raportit janë gjetur shumë parregullsi të cilat e pasqyrojnë komunën e Rahovecit përmes këtij autidimi të brendshëm që i bëhet. Ku i ka cekur disa siç është aktiviteti i auditimit të brendshëm, i cili nuk mbështet zhvillimet e tije në fushën përkatëse e cila ka të bëjë me aranzhimet e qeverisjes të cilat posaçërisht kanë të bëjnë me llogaridhënien menaxhimin e rrezikut, dhe raportimin menaxherial të cilat konsiderohen nga auditori kombëtar si të dobëta. Pastaj obligimet e vitit 2017 në vlerën prej 122,516.00 € nga kategoria e investimeve kapitale si dhe 11,402.00 € nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të paguara gjatë vitit 2018. Pra këto flasin për ato parregullsi të cilat janë gjetur tek menaxhimet e dobëta, dhe tek parregullsi të tjera të cilat flasin për mbi ngarkesa që ka hasur auditori kombëtar, në lidhje me pagesat që janë bërë në vitin 2018, duke ju nënshtruar atyre borxheve të cilat kanë qenë paraprakisht tek auditori i vitit 2017. Po ashtu kategoritë e investimeve kapitale siç janë shpenzime për mallra dhe shërbime, paga dhe mëditje në vlerë prej 113,456.00 €, ishin realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Njëjtë janë vlerësuar edhe shpenzimet për paga dhe mëditje dhe shpenzimet për subvencione që janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të cilën çështje e sqaroi edhe drejtori. Pavarësisht arsyetimeve të prezantuara sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik këto shpenzime nuk plotësojnë kriteret për tu trajtuar si kapitale. Gjatë vitit 2018 komuna është paditur për shuma të konsiderueshme të obligimeve, ku 105,933.00€, janë kryer pagesat direkt nga thesari dhe përmes vendimeve gjyqësore. Po ashtu komuna ka një rritje në vazhdimësi të detyrimeve kontingjente ku vlera e tyre ka arritur shumën prej 32 milion, pra me një rritje prej 690,000.00 € në raporte me vitin e kaluar. Po ashtu kemi një lloje konkluze ose rekomandimi ku thuhet se nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ketë pasoja të rënda financiare. Mendoj se kjo është një paralajmërim mjaftë seriozë ndaj komunës nga auditori kombëtar, të cilin besoj se patjetër duhet që ta keni parasysh. Po ashtu tek përgjegjësia e menaxhimit të performancave thuhet se kryetari i komunës së Rahovecit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik, raportimi financiar bazuar në kontabilitetin e parasë së gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme përmes përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi, mendoj se edhe ky është një rekomandim mjaftë serioz. Tek përgjegjësia e auditorit të përgjithshëm për auditimin thuhet se siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton së një auditim i kryer në pajtim me SNISA-të do të zbulojë çdo keq deklarim që mundet të ekzistoj. Pra kjo është një pikënisje e re të cilën duhet të kemi parasysh edhe ne të cilët e analizojmë këtë auditim, sepse na jepe një lloje porosie e cila thotë se edhe vlerësimi i një niveli më të lartë i sigurisë nuk garanton se një auditim i kryer në bazë të këtyre standardeve përkatëse do të zbulojë çdo keq deklarim. Më poshtë e kemi të ceku edhe konkluzioni përmes menaxhimit financiar dhe kontrollin, edhe pse ka dizajnuar një sistem të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat, megjithatë auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë si rezultat i mos zbatimit të rregullave dhe

udhëzimeve, që kanë të bëjnë me ty hyrat dhe shpenzimet. Mënoj se edhe kjo është një çështje mjaftë me rëndësi sepse preken dy pikat më kryesore si të hyrat dhe shpenzimet. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësimë është procesi i menaxhimit dhe raportimit të llogarive të arkëtueshme, detyrimeve dhe klasifikimi o shpenzimeve. Kemi edhe një të gjetur tjetre e cila thuhet se nga 86 kontratat e nënshkruara gjatë viti 2018 në vlerë prej 7,102,009.00 €, prej tyre 42 kontrata në vlerë prej 4,157,938.00 €, e këtyre kontratave janë nënshkruar në përudhën e fund vitit, kjo një arsyesh shtesë tjetër për mos ekzekutimin e buxhetit dhe sfidë që duhet të adresohet nga menaxhmenti. Po ashtu kemi edhe një të gjetur tjetër tek buxheti final për mallra dhe shërbime, ku thuhet se në krahasim me buxhetin fillestare ishte rritur për 21,763.00 €, por pavarësisht kësaj niveli i realizimit ishte vetëm prej 62%. Kemi edhe mjaftë të gjetura të tjera të cilat flasin mjaftë për performancën financiare vjetore të komunës së Rahovecit gjatë viti 2018, e që po ashtu shpalosin mjaftë parregullsi, të cilat mjaftë mirë janë cekur, këto gjithsesi i konsistonjë një keq menaxhim nga komuna. Pastaj çështja A2 mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë, nga 15 raste të audituara komuna ka kalkuluar gabimisht tatimin duke përllogaritur normën e kualitetit të ndërtimit me 1.1 (shkëlqyeshëm), për objektet e papërfunduara duke mbivlerësuar me 45.00 € ngarkesën tatimore të faturuar, për këta tatimpagues. Ndërsa në dy raste tjera vlera për  $m^2$  nuk është përllogaritur në përputhje me rregulloren e tatimit në pronë duke mbivlerësuar ngarkesën tatimore të tatimpaguesit prej 47.00 €. Shkaku i kësaj ishte vlerësimi jo i drejtë i pronave nga ana e anketuesve në teren, edhe kjo është një e gjetur ose një porosi e cila me të vërtet është edhe një çështje e ndjeshme, sepse nëse komuna vazhdon kështu me këto gabime, ka mundësi të merë edhe padi nga tatimpaguesit. Po ashtu është gjetur se komuna ka bërë shkelje gjatë punësimit të punëtorëve me kontratë sepse në fillim ka dhënë kontrata duke filluar me kohëzgjatje prej 120 ditës, pastaj ka bërë vazhdimin e këtyre kontratave për 6 muaj, të nderuar kjo nuk konsiston me ligjin dhe është shkelje ligjore. Tek pagat dhe mëditje, buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte prej 7,259,001.00 €, kurse shpenzimet ishin prej 7,219,001.00 € apo 99%, pra kjo pjesë është e shfrytëzuar mirë. Sa i përket mangësisë në menaxhimin e personelit, për 19 zyrtar të cilat janë të angazhuar në Drejtorin për Emergjencë dhe Siguri, komuna nuk ishte në gjendje të na ofroj dosjet e kompletuara dhe kontratat e këtyre zyrtarëve në bazë të cilave kryhet kompensimi i pagave. Është një çështje për të cilën përsëri thuhet se është bërë shkelje të ligjit nëse këta janë nëpunës civilë dhe marrin pagat e tyre ose shtesat të cilat janë të përcaktuara me 30.00 €. Përmes kësaj të gjeture auditori ka kërkuar që komuna e Rahovecit këta persona të i regjistroj në regjistrin civilë të qeverisë, e jo të janë nën komunën e Rahovecit. Dosjet e pa azhurnuara të personelit, sipas ligjit o4/L-032 për arsimin para universitar neni 20 paragrafi 2.2 përcakton se drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit duke përfshirë detyrat e caktuara për vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit. Pasi auditori kombëtar i tregon detyrat e drejtorit të DKA-së, do të bëjë një pyetje për drejtorin rrëth rastit që doli në media, në një shkollë të komunës së Rahovecit mësimdhënësi ka rrahur nxënësin, kurse drejtori i DKA-së, doli në media dhe tha se nuk ka dijeni për rastin. Si e jepe drejtori këtë përgjigje e cila nuk është fare komode ose modeste për një drejtor të arsimit, sepse ai i di detyrat dhe duhet patjetër të jetë i informuar për secilën shkollë çka është duke ndodhur.

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për ét gjithë të pranishmit, kolegët paraprakisht i kanë cekur shumicën e çështjeve dhe nuk ja vlen që të përsëriven përsëri ato gjëra, ajo që dua të them unë është se ne i gëzohemi opinionit që auditori kombëtar e ka ndarë si të pamodifikuar me theksim të çështjes, ky është interes i qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe janë ata që përfitojnë nga kjo. Po ashtu realisht pajtohem me parafolësit që thanë se opinionin që e ka dhënë auditori kombëtar, dhe të gjeturat që gjenden brenda këtij rapporti më duket se janë paka shumë kontradiktore, sepse sikur të ishte edhe brendia e këtij rapporti ashtu sikurse që e ka dhënë opinion auditori atëherë edhe për ne kishte me qenë mirë, asgjë nuk prish punë që jemi opozitë, në fund të fundit ne të gjithë jemi qytetarë të komunës së Rahovecit. Të nderuar ka mjaftë lëshime gjatë kësaj qeverisje dhe janë të cekura shumica në këtë report, po ashtu edhe drejtori në fillim e ceku se ka pasur pak probleme me pasqyra financiare dhe me keq klasifikime etj. e nderuara znj. Florida Krasniqi e përmendi që kemi dallim në mes realizimit të buxhetit që e ka dhënë auditori kombëtar dhe ne kur e kemi pasur reportin financier për vitin 2018. Pastaj është një e gjetur ku ceket mangësi në menaxhimin e personelit, pra dosjet e pa kompletuar për 19 zyrtar, mendoj se disa gjëra kanë mundësi të kryhen me një

angazhim të vogël, por nga pakujdesia vije që auditori të na jepe vërejtje. Tek çështja A7 ceket si e gjetur Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët për banim të familjeve me nevojë në Rahovec, edhe pse projekti ka filluar shumë herët dhe është dashur të përfundoj në vitin 2017, por në realitet ende nuk ka përfunduar dhe këtu ka shkelje ligjore sepse komuna nuk e ka paraparë që të bëhet vazhdimi i kësaj kontrate. Të nderuar mendoj se ka pasur më pak të gjetura në raportin e vitit 2017, se sa në raportin e viti 2018, prandaj koleg të nderuar nuk e di se sa ka mbetur të i besohet organeve kompetente që i kryejnë punët e vete, sepse thjeshtë edhe ata si duket po ndikohen nga politika. Për më shumë do të diskutoj në mbledhjen e kuvendit, sepse kolegët i përmenden shumicën e të gjeturave.

**Dervish Çadruku** – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, do i kisha thënë disa fjalë pak a shumë përbledhëse sepse shumica e gjëra u thanë nga parafolësit. Më vije mirë për lajmin që na e dha drejtori se opinioni i auditorit rrëth performancës së punëve tona ka dalë i mirë ose pozitiv. Por të nderuar nëse e marrim këtë material dhe e shfletojmë me vëmendje do të shohim se kemi një shpërputhje, rëndësi ka që ata neve na kanë klasifikuar mirë, por po ashtu rëndësi ka që ne vetë të i marrim më seriozisht vërejtjet e auditorit. Janë më shumë se 50 vërejtje në këtë raporte që i ka dhënë auditori për disa drejtori dhe resorë të cilat kishte me qenë mirë që të merret menaxhmenti më tepër që këto të përmirësohen. Që në fletat e para të raporti ne e kemi një vërejtje jo të mirë ku ceket se shpenzimi i buxhetit është bërë rrëth 96%, dhe nëse i llogarisim na del që rrëth 632,000.00 € na kanë mbetur pa u shpenzuar nga buxheti i komunës. Të nderuar neve disa dobësi janë duke na përcjellë për çdo vite si komunë, nëse shkojmë në zyrën e personelit do të shkojmë se na është dhënë vërejtje se disa punëtor janë pa dokumentacione adekuate, pastaj nëse i marrim dhe i shkojmë shpenzimet e pa evidentuara, ose inventarizimin e pasurisë jo financiare, do të shohim se këto parregullsi na kanë përcjellë edhe më parë tek drejtoria e shëndetësisë, ku ceken rrëth 3000 litra të pa evidentuara, është mirë që këto të përcillen dhe të përmirësohen dhe mos të ndodhin më sepse kjo është e dëmshme dhe e paligjshme. Pastaj makinat e komunës thuhet se nuk janë duke u regjistruar kilometrazhet gjatë përdorimit, pastaj problem tjetër është kur dalin në teren inspektorati na dele një shpërputhje e objekteve të ndërtuara, të pa ndërtuara, gjysmë të ndërtuara etj dhe me këtë kemi humbje si ne ashtu edhe qytetarët. Pyetje ime është në se ju është kualifikuar gabimisht qytetarëve, a ju kthehet kompensimi në kuptimin material të fjalës. Po ashtu ne kemi probleme të trashëguara edhe në zyrën e prokurimit, ku ceken si faturat e papaguara me kohë, pastaj vazhdimi i projektit me disa nuanca ma tepër se që lejohet ose që nuk është e përcaktuar me projekt. Po ashtu kemi probleme të trashëguara sa i përket pagesave me gjykata, dhe më këtë përsëri buxheti i komunës është duke humbur sepse komuna duhet të paguaj shpenzimet e gjykatave ose të përmbaruesit, dhe kjo shkon krejt në dëme të qytetarëve sepse shpenzohen taksat e tyre. Ajo që më bërë përshtypja mua është se nëse kryetari i komunës i ka më shumë se 50 vërejtje në këtë raport dhe ai me më shumë se 20 vërejtje nuk i ka përfillur, pyetje ime është: Pse ka ndodhur kjo a kanë qenë të parëndësishme për te apo nuk ka arritur të merret me te. Po ashtu e kemi edhe një dukuri e cila është duke na përcjellë goxha moti dhe askush nuk është mare me te, kemi të bëjmë me punëtorët e drejtorisë për emergjencë, këta punëtor nuk e dimë a janë punëtor tanë apo janë punëtor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sepse diku rrëth 10,000.00 € paguan komuna për ta për arsy se nuk është i definuar statusi i tyre, kjo duhet të definohet një herë e mirë. Dhe përfund kemi pasur diku rrëth 45,000.00 € të hyra të paraparë nga inspektorati nga evidentimi i pronave të paregjistruar, kurse shihet se kemi zero të hyra nga kjo kategori, është mirë që të na jepe dikush përgjigje pse ka ndodhur kjo.

**Afrim Limani** – Të nderuar anëtarë të KPF-së ju faleminderit për pyetjet e parashtruan, e nderuara znj. Florida Krasniqi dhe shumica e anëtarëve e parashtruan një pyetje të ngjashme, po ju përgjigjim, të nderuar/a ndryshimi në këtë është se ne raportin financier sipas ligjit të financave publike detyrohemë ta bëjmë në bazë të raportit të buxhetit të planifikuar, dhe ajo përqindje dele saktë e jona. Kurse auditori kombëtar të gjitha mjetet që mblidhen tek ne, ai pastaj e nxjerrë përqindjen, dhe kjo është arsyja pse ka rënë përqindja. Tash do ju shpjegoj pse ka rënë përqindja, buxheti fillostar me buxhetin përfundimtar ka dallim rrëth 600,000.00 €, pra ne kemi pasur buxhet shtesë nga Ministria e Financave, ku kanë qen për investime kapitale rrëth 300,000.00 €, ku 100,000.00 € kanë qenë nga ministritë e linjës, kurse pjesa e mbetur ka qenë nga banka botërore, ky buxhet kryesisht ka qenë i orientuar në investime kapitale. Dallimi tjetër ka qenë sepse buxhetin në të hyra kapitale e kemi pasur të planifikuar rrëth 1,6 milion, por ne në fund të viti nuk

kemi mundur që të inkasojmë këto të hyra por vetëm rrëth 1.1 milion dhe pjesa e pa mbuluar e ka luhatur mos realizimin e buxhetit. Pjesën grandit e kemi shfrytëzuar maksimalisht, kanë mundur të shkon në suficit deri në 30,000.00 €. Nëse ju kujtohet në mbledhjen e muajit shkurtë ne kemi pasur rrëth 400,000.00 € mjete që janë bartur dhe ky transfero goxha mirë w ka zbutur situatën. Pajtohem me të gjitha pyetjet që i bërë z. Fehmi Cena, nuk dua të i përsërisë të dy çështjet që i ceka më herët, sa i përket mos barazimit të tatimit në pronë i gjithë problemi është tek siftëveri – programi. Sa i përket çështjes së dytë nuk dua të them që e kam gjetur kështu por, kur kam ardhur në pushtet e kam gjetur ashtu borxhin, ku ka ardhur ajo faturë ku ne e kemi ekzekutuar dhe pastaj gjithçka ka qenë në rrëgull. pajtohem po ashtu edhe me pyetjet e znj. Fahrije Lushi, e nderuar detyrimet kontingjente janë të gjitha palët juridike dhe fizike që e kanë paditur komunën, jam në kontakt të vazhdueshëm me avokatin e komunës dhe sipas tije kur të i vije koha këto do të eliminohen, sepse të gjitha këto padi janë pa fakte dhe pa argumente. E gjitha kjo ngjarje lidhet me periudhën mbas lufte, pra ende pa e mare pushtetin institucionet tona. Sa i përket kontratatave me shërbime të veçanta është shumë e vërtet që unë dy punëtorëve ja kam vazhduar kontratat dhe kjo është në kundërshtim me ligjin, këta punëtor janë të tatimit në pronë, ku janë duke e bërë një punë shumë të mirë, janë mësuar me punën, dhe janë tërë kohën në teren. Arsyja ka qenë se nëse unë i largoj këta dhe i marr dy punëtor të ri, paramendoni duhet të humbasim kohë edhe dy muaj deri sa të mësohen ata me punën, prandaj jam detyruar ndoshta ma mirë me e shkelë ligjin sesa me i marr edhe dy punëtor tjerr të rijnë. E nderuara Lushi kishte me qenë mirë që të vini ju ose edhe ndonjë koleg tjetër në zyrat e tatimit në pronë dhe të bindeni dhe të shihni punën se si kryhet në ato zyre, po ju them sinqerisht se me softverë e kanë problemin të gjitha komunat e Kosovës. Po ashtu pajtohem me të gjitha rekomandimet që i dhanë z. Rasim Fazliu dhe z. Dervish Çadraku, për pyetjet e parashtruara di ju përgjigjem në mbledhje të kuvendit. Në fund ne duhet të gëzohemi që pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit kanë dalë pozitive, kjo është çelës që të vazhdohet më tutje.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin dhe pyetjet e bërë, kalojmë në pikën e radhës:

### 3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës komunale.

**Afrim Oruçi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sipas legjisacionit në fuqi propozoj anëtarëve të KPF-së dhënen e pëlqimit për këmbimit e pronës publike komunale me institucione qendrore, për interes publike. Do të mundohem të jem ma praktik gjatë prezantimit të kësaj pike, të nderuar ne kërkojmë nga ju që të na jepni leje që të i këmbejmë 60 ari tokë e komunës, e cila gjendet në zonën kadastrale në Kaznik, kjo tokë është nën menaxhimin e agjensionit pyjor, këmbimi bëhet për ndërtimin e një kulle në vend rrënjën e dëshmorëve të kombit. Pra ne i kemi 60 ari tokë tek kryqi i Opterushës që i kemi shpallur me interes të përgjithshëm vitin e kaluar, në këtë pjesë është vend rrënja e dëshmorëve “Xhelal Hajda – Toni”, “Selajdin Mullabazi – Mici”, “Bektesh Haliti” dhe Nezir Ymeri”. Ne e kemi në kodë të paraparë me buxhet disa mjete ku siç e thash kemi në planë të ndërtojmë një kullë të gurit, por për ta ndërtuar këtë kullë të gurit neve na nevojitet që kjo pronë të jetë pronë komunale, ne nuk kemi pasur pronë tjetër për të këmbyer përvèç kësaj prone që është në Kaznik. Ne kërkojmë që ju të votoni këtë pëlqim për këmbim që ne të ja japim agjensionit pyjor 60 ari në kaznik dhe ne të i marrim 60 ari tek kryqi i Optrushës, në mënyrë që të vazhdojmë me procedurat e tjera.

**Rasim Fazliu** – Paraprakisht po e them se jam pro këtij këmbimi sepse këtu bëhet fjalë për ndërtimin e një kulle për heronjtë e Kosovës edhe pse këtu e keni cekur si dëshmorë, besoj se është dashur të shkruhet heronjtë, propozoj që për mbledhje të kuvendit kjo të përmirësohet. Po ashtu është mirë të bëhet përmirësimi i disa fjalive në këtë vendim sepse nuk janë të shkruar ashtu si duhet, sepse kur nuk është e shkruar mirë ndryshon edhe kuptimi i fjalës.

**Fehmi Cena** – Po ashtu edhe unë në parim pajtohem me këtë këmbim të kësaj sipërfaqe, por pyetje ime është kështu ne një herë e kemi shpallur interesin e përgjithshëm këtë zonë vitin e kaluar, tanë kjo është pronë shtetërore edhe pjesa e menaxhuar nga agjioni i pyjeve edhe pjesa që i takon komunës. Të nderuar a nuk mundet të ndërtohet një projekt sikurse ky që jeni duke e prezantuar në pronën që është shfrytëzues ekonomia e pyjeve, kjo pronë është pjesë e Kosovës dhe këta heronjtë nuk janë vetëm të komunës së Rahovecit, këta janë heronjtë e Kosovës. E them këtë me të vetmen arsyen që të kursehet toka e cila është pronë e Komunës, siç e dini komuna jonë ka shumë pak prona dhe dita ditës ajo vetëm është duke u këmbyer dhe është duke mbetur shumë pak. Prandaj pyes a kishte me pas mundësi që kjo kullë të ndërtohet në këtë

vend pa bërë asnjë këmbim, le të jetë shfrytëzues ekonomia e pyjeve, ne e dimë që kjo agjensi i ka në shfrytëzim mijëra hektar, po ashtu e dimë se si janë duke i menaxhuar këto toka, nuk është duke i shfrytëzuar edhe aq shumë këto prona, prandaj le ta kursejmë komunën për 60 ari. E pyes drejtorin a ka mundësi ligjore kjo të bëhet, sepse ne do të kemi edhe raste tjera në të ardhmen, prandaj është mirë që të shikohet mundësia se këto përmendore të bëhen në këto vende si sot që e kemi rastin.

**Fjolla Duraku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ashtu edhe unë jam pro këtij propozimi për këmbim të këtyre pronave, pasi e dimë se ne e kemi historinë të lavdishme dhe si simbol i kësaj historie është nulla, e që në fakt i simbolizon edhe të rënët, pra dëshmorët e kombit si Toni dhe Mici dhe dëshmorët e tjerë.

**Afrim Oruçi** – Inderuari kuvendar z. Cena, pyetje juaj është diskutuar në zyrën ligjore, ku kemi kërkuar një mendim, por sipas tyre është e pamundur të ndërtohet në parcela të cilat menaxhohen nga agjensioni pyjor, ligji i Republikës së Kosovës me nr.10/2019 e precizon saktësisht këtë. Ky ligj ja lejon kryetarit këmbimin e pronës përmes kuvendit 1 me 1, qëllimi i kësaj është qe ne dëshirojmë me e rregullue këtë, ne nuk mundemi të investojmë mbi 30,000.00 € kur nuk e dimë se ky agjsnioni ose ndonjë që do të vije pas këtij agjensioni do të bëjë me këtë parcel. Ne e dimë që do të ndërtojmë një kullë të vogël simbolike, por ne qëllimi i kemi kërkuar 60 ari, me të vetmin arsyetim sepse agjsnioni i ekonomisë së pyjeve çdo ditë këto prona i jepe me qira, prandaj ne nuk e dimë se në të ardhmen kut do ja japë me qira. Qëllimi jonë është që ne ta ndërtojmë këtë kullë në tokë të komunës në mënyrë që mos të kemi më probleme, jemi 20 vite pas lufte me ne organizatën e OVL-së jemi munduar të i identifikojmë se ku janë vend rrënjet e dëshmorëve. Pas lufte pronarët e tokave private janë shprehur me vetë dëshirë që të ndërtohen bustet e dëshmorëve në tokat e tyre private, por tanë ne kur kemi shkuar që të takohemi me ta që të i kthejmë këto prona ku janë bustet e dëshmorëve në toka komunale, ata na thonë na jepni ju diku tjetër ndonjë pronë ose mjete financiare kompensim ne ju japim, përndryshe nuk ju japim. Nëse ne nuk e rregullojmë këtë shumë shpejtë fëmija i tije ka mundësi që në një të ardhme të shpejtë të merr ndonjë bager dhe të rrafshoj pjesën ku janë bustet, nëse ne nuk ja kompensojmë, për këtë arsyje ne dëshirojmë që kjo të jetë pronë e komunës.

**Rasim Fazliu** – Të nderuar ne ashtu nuk mundemi në KPF të vendosim, por jemi duke i dhënë mendimet tona, prandaj propozoj që kjo pikë të shkojë për mbledhje të kuvendit dhe pastaj atje të vendosim dhe të marrim vendim në favor të asaj që është më e mirë.

**Fehmi Cena** – Besoj se ju e kuptuat qëllimin tim, qëllimi i komunës nuk është vetëm të ndërtojmë përmendore, por qëllimi i komunës duhet të jetë që ta mbrojë edhe tokën e vetë sepse e siç e thash e kemi shumë me rezerva. Drejtori e sqaroi se vlera e kësaj toke është shumë e dobët në krahasim me këtë që do ta marrim, pikërisht kur jemi këtu, në të ardhme komuna është mirë që të shikojë se nëse dëshiron të bëjë këmbime, komuna mundet të shikojë edhe me e ble toka, sepse çmimi i tokës ndryshon. Sot ka mundësi të jetë në atë pjesë shumë lirë, por ka mundësi që dikur të jetë shumë shtrenjtë sepse ne duhet të vlerësojmë tokën komunale.

**Dervish Çadraku** – E di shumë mirë që pas lufte ne si popull kemi qenë euforikë, prandaj kur ka qenë fjala për me i vendosë përmendoret kemi qenë të pajtueshëm që kjo të ndodhë kudo qoftë, por tanë 20 vite pas njëra qeveri pas tjetrës ka punuar me fjalën e dhënë pra i kanë vendos përmendoret. Por njerëzit tanë kanë filluar ta ndryshojnë mendimin, prandaj është mirë që këto gjëra të rregullohen me ligj ose deklarata, dhe pastaj të nuk ke drejtë më të kërkosh atë pronë sepse e ke dhënë një nënshkrim që e ke dhënë këtë pronë. Në këto raste tanë si jemi ka mundësi ndoshta personi që e ka dhënë nuk e lë ndërgjegjja që të kërkojë pronën, por djali ose nipi i tije ka mundësi të kërkojë dhe të thotë se kjo pronë është e imja, sepse edhe në dokumente zyrtare do ti figurojë si e tij. Prandaj është mirë që të fillojë nga ne dhe të respektojmë ligjin, në mënyrë që mos të kemi probleme më me këto vlera të luftës të cilat ata kanë rënë për ne, kurse ne tanë të kemi kontest e të kapemi mes vete dhe ta zhvlerësojë këtë veprë.

**Kryesuesi** – Pasi nuk ka askush më të diskutoj sa i përket kësaj pika, konstatoj se Propozim vendimi i kryetarit të komunës për këmbimin e pronës komunale kalon për mbledhje të kuvendit. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për raste të veçanta.**

**Afrim Oruci** – Të nderuar anëtarë të KPF-së me kënaqësi kemi pranuar një kërkesë nga Ushtria e Republikës së Kosovës, e cila kërkon nga komuna e Rahovecit dhënien me qira të pronës me afat të caktuar prej 10 viteve, gjithnjë sipas ligjit të Republikës së Kosovës për dhënie me qira të tokave në raste të veçanta, si për ushtri, konsullata, polici dhe agjensione të tjera, që shkon pa kompensim. Qëllimi i dhënien së kësaj toke është rruajtja dhe rritja e vlerës të pronës publike, gjithashtu edhe ngritja e nivelit të trajnimeve dhe profesionalizimit të ushtarakeve, të batalionit të dytë, të brigadës së reagimit të shpejtë të bazuar në misionin e Ushtrisë së Republikës së Kosovës. Ju ftojë që pas shqyrtimit ta votoni pro këtij propozim vendimi.

**Rasim Fazliu** – I nderuar drejtor kjo kërkesë që ka ardhur nga komandanti i batalionit të dytë a është private apo në emër të ushtrisë, sepse nëse ka ardhur kërkesa nga ai si individ dhe dëshiron të hapë ndonjë biznes duhet të dimë, kishte me qenë mirë të na jepni pak më shumë sqarime. Nëse është për Ushtrinë e Kosovës normalisht se do të jemi pro të gjithë, por nëse është diçka private dhe ai dëshiron të hapë ndonjë poligon për përfitime personale, atëherë ne edhe këtë përsëri duhet ta diskutojmë. Po ashtu përsëri ka disa gabime drejtshkrimore në këtë propozim vendi, dhe kishte me qenë mirë që të përmirësohen për kuvend. Po ashtu është mirë të harmanizohen të gjitha vendimet, sepse kemi raste kur thuhet: Propozon Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe KPF-së, kurse në propozim vendimin tjetër ceket: Propozon KPF-së dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, prandaj propozova që të përmirësohen dhe të na vinë të përmirësuar në mbledhje të kuvendit.

**Dervish Çadruku** – I nderuari drejtor ku është saktësisht ky vend që e kërkon Ushtra e Republikës së Kosovës.

**Fehmi Cena** – Pajtohem me parafolësin kur e tha se kërkesa nuk është adresuar mirë, sepse duhet të jetë në emër të batalionit e jo në emër të individit. Po ashtu dua një sqarim rrëth poligonit i cili do të jepet në shfrytëzim, këtu ceket tek poligoni i qitjes së KFORIT gjerman, unë e di saktësisht se ku është ai ven, por tani ai poligon sa e di është dhëndëruar në tokë punuese, prandaj z. Dervishi pyeti me vend se ku është kjo pjesa që është duke e kërkuar Ushtria e Republikës së Kosovës. Po ashtu qytetarët janë duke pyetur se e kujt është ajo pjesë, a është nën menaxhimin e agjencisë së pyjeve, komunës apo private, ne gjithmonë kemi menduar se është pronë shtetërore, por sigurte është pronë private pasi është duke u punuar.

**Afrim Oruci** – I nderuari z. Fazliu kërkesa për mua si drejtor është shumë publike dhe shumë zyrtare, është kërkesë e protokolluar, ka emër dhe mbiemër, ka nënshkrim, dhe nga ne është trajtuar si në rregull. Kurse sa i përket korrigjimit unë publikisht e falënderoj kuvendarin për korrigjin që na e bëri vendimeve, ne jemi në proces të punësimit të një lektori dhe në të ardhmen të gjitha këto dokumente një herë do i shkojnë lektorit e pastaj do të vinë në kuvend. Sa i përket vendit të kërkuar, të nderuar kuvendar, toka e cila ka qenë poligon i KFORIT, që nga fillimi ka qenë tokë e NBI-së, KFORI në atë kohë e ka mare në shfrytëzim, është një vendim për këtë. Pastaj kur është privatizuar me ligjin e Republikës së Kosovës kjo tokë, pastaj privatizuesi nuk a dashur ta largojë KFORIN për të mirat që na i ka sjellë neve si vend, pastaj në momentin që është tërheq KFORI, pronari është kthyer në vendin e vetë. Sa i përket tokës që është duke e kërkuar Ushtria e Republikës së Kosovës, kjo tokë është në kufi me këtë që e diskutuan, por përbashi saj, është pronë e komunës, por besoj se për kuvend do ju sjellim edhe orto - foto ku do të shihni saktë se ku gjendet kjo pronë.

**Kryesuesi** – Pasi nuk ka diskutues tjerë të lajmëruar për këtë pikë, Konstatoj se Propozim vendimi i kryetarit të komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për raste të veçanta kalon për mbledhje të kuvendit. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

#### **5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesë e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 11000 m<sup>2</sup> në Rahovec.**

**Afrim Oruci** – Përvihendje edhe një herë të nderuar kuvendarë para jush e keni propozim vendimin e kryetarit për shpallje me interes të përgjithshëm të një pjesë të parcelës 02240-1, kemi të bëjmë me 1 hektar e 10 ari, saktësisht ky vend është tek rruga e transitit. Ne i kemi disa parcela përfund dhe përbashi rrugës së transitit, kjo parcelë është nën menaxhimin e agjencionit pyjor të Kosovës, qëllimi ynë është që me e shpallë këtë zona me interes të përgjithshëm, dhe të bëhet rruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale, dhe pastaj të përdoret sipas nevojave për interes të përgjithshëm. Tani pas urbanizimit të asaj pjesë interesimi i qytetarëve

është i madh që me i marr këto parcela me qira që janë përskaj rrugëve, kurse ne si komunë i kemi planet e tjera dhe dëshirojmë me i ruajte këto sipërsfaqe. Ju ftojë që pas shqyrtimi ta përkrahni këtë propozim vendim që të kalojë për kuvendit.

**Rasim Fazliu** – Të nderuar propozoj që kjo pikë të kalojë për mbledhje të kuvendit dhe pastaj aty do të marrim qëndrim sa i pérket kësaj pike.

**Kryesuesi** – Konstatoj se Propozim vendimi i kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërsfaqe prej 11000 m<sup>2</sup> në Rahovec, kalon për mbledhje të kuvendit. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

**6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërsfaqe prej 42099 m<sup>2</sup> në Rahovec.**

**Afrim Oruci** – Të nderuar kjo sipërsfaqe është tek Maja e Shkodranit, qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm është se, ne jemi tanë në fazat tjera të funksionalizimit të kësaj pike, po ashtu edhe kjo pronë është nën menaxhimin e agjensionit pyjor të Kosovës. Ne tanë jemi në përfundim të shtegut të ecjes, po ashtu planifikojmë që të shtrojmë edhe rrugë me asfalt, ne jemi të interesuar që ti sigurojmë rrëth 4 hektar tokë përreth kësaj pike, pra të i shpallim një herë me interes të përgjithshëm, po ashtu qëllimi është që ta mbrojmë dhe ruajmë këtë tokë, dhe në të ardhmen me funksionalizu me të vetmin qëllim që mos të merret me qira nga agjensioni që është nën menaxhimin e pyjeve. Ju ftojë që ta përkraheni këtë propozim vendim të kryetarit për mbledhje të kuvendit.

**Fehmi Cena** – Kam vetëm një kërkesë që në mbledhjen e ardhshme të kuvendit komunal të prezantohen me projektor dhe me orto foto këto pika, në mënyrë që ne saktësish të i dimë vendin ku janë këto pika.

**Kryesuesi** - Po i nderuar, për kuvend na premtoi edhe drejtori që do të jenë me orto foto dhe me projektor këto pika. Të nderuar kuvendar konstatoj se Propozim vendimi i kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërsfaqe prej 42099 m<sup>2</sup> në Rahovec, kalon për mbledhje të kuvendit. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

**7. Informatë nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport për objektet e trashëgimisë kulturore – historike të Komunës së Rahovecit.**

**Bjondina Kleqka** – Përvshëndetje për të gjithë pranishmit, pas kërkesë së kuvendarit z. Fehmi Cena për të sjellë informatën rrëth objekteve të vjetra të komunës së Rahovecit, ne si drejtori e kemi bërë një mbledhje të shënimive duke u bazuar në analizën 19 vjeçare, përkatësisht që nga periudha e vitit 2000 deri më tanë. Analizimi i gjendjes fizike të aseteve të trashëgimisë kulturore është bërë në bashkëpunim me trashëgimin kulturore pa kufi CHVB – Kosova, ku është përpiluar kjo listë e monumenteve në gjendje më të mirë, dhe atyre që janë nënshtuar shkatërrimit sistematik. Në listën që ju kemi dërguar në kopje fizike i gjeni disa shtëpi të vjetra qytetare, kullat që gjenden në Rahovec, objektet sakrale islame siç janë xhamit, teqe, tyrbe dhe kishat, pastaj trashëgimit kulturore si në qytat ashtu edhe në fshatra lidhur me secilin objekt të trashëgimisë, dhe objekteve të cilat gjenden në kopje fizike që ju kemi dorëzuar.

**Dervish Çadraku** – E kam lexuar këtë raport dhe ka shumë gjëra interesante, ka vende që ne nuk i kemi ditur, është mirë që këto vende të ruhen dhe të evidentohen, por mendoj se ka një mungesë të bashkëpunimit me bashkëvendësit, sepse mendoj që ka ende vende të cilat duhet të evidentohen dhe të mbresin si trashëgimi e përhershme. Do të nisem nga fshati imë, ku e di se janë disa varreza të kruhqve quhen, të cilat janë në mes të fshatit, dhe jam duke parë që këtu nuk janë të evidentuara, pastaj është një hambar i vjetër ndoshta i ka 100 vjet edhe ai nuk është i evidentuar, por këto janë gjëra ndoshta që duhet të bisedohet me kryetarët e fshatrave. E kemi në fshatin Ratkoc Bunarin e Madh që e quajnë, nuk dihet saktë kur është ndërtuar ky bunar, kurse këtu nuk është i evidentuar, mendoj se është mirë që kjo listë të shqyrtohet edhe një herë sepse ka mundësi të ketë edhe monumente tjera. Pastaj ajo që më bërë përshtypje është se në Hoçë të Madhe ishin diku rrëth 15 kisha, çfarë forme kanë ato kisha sepse nëse janë 15 mendoj se ato zënë hapësirë të madhe kurse unë nuk i kam parë këto kisha.

**Rasim Fazliu** – Falënderoj drejtoreshën që na ka sjellë këtë informatë, po ashtu falënderoj edhe propozuesin që e ka propozu që të na vije kjo informatë. Të njëjtën gjë që e ngriti z. Çadraku desha edhe unë të ngrisë, kishte me qenë ndoshta mirë që të hulumtohet pak më shumë dhe të shikohet mos ka mbetur edhe ndonjë monument i trashëgimisë kulturore që është i pa evidentuar. Desha të përmendi konkretisht në fshatin Celin

ne e kemi një qeshma ku është furnizuar i gjithë fshati me ujë, edhe pse nuk kam kurfarë informatë se nga kur daton kjo, por nëse ja vlen që të jetë pjesë e kësaj liste e trashëgimisë kulturoresi kjo dhe shumë objekte tjerë të trashëgimisë kulturore kishte me qenë mirë të jenë.

**Fehmi Cena** – E falënderoj paraprakisht drejtoreshën që e ka përgatit këtë informatë, është e vërtet se në njëren nga mbledhjet e kaluara e kam kërkuar këtë informatë që të jetë në mbledhje të kuvendit, me profesion jam mjeqë por pasion e kam trashëgimin kulturore historike dhe kjo më ka bërë përshtypje, dhe mendoj se kjo është diçka me rëndësi. Sepse të gjitha këta kanë të bëjnë me historinë e vendbanimit dhe të komunës, e nëse ne dëshirojmë të shënojmë një histori të përgjithësuar atëherë nuk kemi mundësin të bëjmë nëse nuk e përfshimë lashtësinë. Rahoveci si qytet dhe si komunë ka objekte të vjetra të trashëgimisë kulturore të mjaftueshme, e kam ditë dhe e kam thënë se për ne është hapi i parë që të kemi një raport në kuvend, e di që ka objekte të tjera shtesë që nuk janë evidentuar dhe që e meritojnë të evidentohen. Janë përfshirë në mënyrë kronologjike këto objekte, në fillim vetëm dua të qartësoj se Drejtoria për Kulturë dhe Sport në bashkëpunim me trashëgimin kulturore pa kufi, desha ta pyes a është ky institucion shtetëror sepse nuk është e ceku ministria përkatëse ose instituti por trashëgimin kulturore pa kufi, a janë këto objekte të regjistruar edhe në institucione shtetërore përkatëse sepse nëse janë edhe aty të regjistruar atëherë janë me të vërtet nën mbrojtje. Ka objekte kulturore si në qytet ashtu edhe në fshatra që nuk janë në këtë listë, pra nuk janë të evidentuara, po ashtu në qytet janë disa shtëpi që nuk janë të evidentuar, njëra nga ta ka qenë tek sheshi i republikës ku e kam parë, por pas dy jave kjo shtëpi është rrënuar, është për të ardhur keq që është rrënuar ajo shtëpi, ndoshta ka qenë ajo shtëpi më e mirë ose më e ruajtur nga të gjitha këto që janë të regjistruar në këtë listë. Jam i sigurte që ka edhe shtëpi të tjera brenda qytetit që duhet të merren nën mbrojtje të shtetit, pastaj janë edhe disa mulli që janë restauruar por ju nuk i keni përfshirë në këtë listë. Propozoj që të dalim m enjë kërkesë që ta formojmë një komision të përfshirë nga drejtoria për kulturë dhe kuvendi, ku do të punoj në evidentimin e objekteve të tjera shtesë, e pastaj ne si kuvend do të shikojmë se a i plotësojnë ato kushtet që të janë pjesë e listës së objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike.

**Bjondina Kleqka** – Objektet e vjetra që janë përfshirë në këtë listë janë në bashkëpunim me CHVB-në, analizimi i gjendjes së aseteve të trashëgimisë komunale është bërë nga CHVB-ja në bashkëpunim me komunën. Të nderuar ka objekte që nuk janë nën mbrojtje të ligjit, pra që e merë vendimin ministria në bashkëpunim me komunën dhe për këtë arsyen nuk i kemi përmend, para juve e keni listën vetëm me analizim të objekteve e jo ato që janë të përfshirë në listën e mbrojtjes. Për kuvend nëse doni ne mundemi të i ndajmë objektet që janë në listën e mbrojtjes nga ligji dhe atyre që janë vetëm si objekt i vjetër.

**Nënkryetari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kjo pikë le të mbetet kështu si është, pra le të mbetet kjo informatë dhe le të shkojë në kuvend, e dimë që ka mangësi, por pas formimit të komisionit dhe pasi ata i përbledhin të gjitha monumentet e vjetra historike, do të dalim me një raport, ku do ti prezantohet KPF-së dhe pastaj kuvendit. Jam duke parë unë në këtë raporte që në fillim që ka lëshime sepse ka shtëpi në Rahovec që më nuk ekzistojnë, prandaj pas përfundimit të komisionit rrumbullakohet lista dhe komuna pastaj e ka një listë më të quartë dhe të detajuar sa i takon objekteve të trashëgimisë kulturore.

**Kryesuesi** – Të nderuar anëtarë të KPF-së ju falënderoj për diskutimin e zhvilluar, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

#### 8. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.

**Nënkryetari** – Të nderuar të ju them të drejtën vetë kam qenë pjesë e komisionit i cili e ka kryer punën sa i përket emërtimit të emrave, por në bazë të ankesave të shumta dhe kërkesave të reja të qytetarëve nga e gjitha komuna e Rahovecit, ideja është që përsëri të formojmë një komision sepse gjatë dërgimit të materialit në agjesion kadastral ka pasur disa mangësi. Kryesisht mangësitë kanë qenë të gabimit teknik dhe pastaj nuk kanë dalë emrat ashtu siç i ka mare për bazë komisioni, ne tanë kërkojmë nga ju që ta formojmë një komision të ri për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe shesheve, po ashtu edhe ky komision për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve. Po ju përmedni një gabim që është bërë gjatë vëties së emrave, në programin e Excel, në kolona vendoset një emër p.sh Fatmir Iska, pastaj përfund nëse ja bënë enter dalin edhe emrat e tjerë, pastaj e kanë bërë save, por gabimi është se ne atë kolon dele vetëm një emër, sepse për me dalë edhe emrat e tjerë që janë në atë kolon duhesh të i shtypësh edhe dy herë në atë kolonë. Kurse kur ja kanë dërguar agjensionit kadastral

i ka dalë vetëm emri i parë emrat tjerë nuk kanë dalë, ky është ai gabim që është bërë, për atë p.sh një rrugë e gjatë 2 ose 3 km ka dalë vetëm me emrin Fatmir Iska, emrat tjerë nuk janë dalë.

**Kryesuesi** - Të nderuar me të vërtet kemi një numër të konsiderueshëm të ankesave, por po ashtu kemi kërkesa përmirësim të emrave sepse janë shkruar gabimisht dhe ju është ndërruar edhe gjinia, dhe me të vërtet duhet të trajtohen këto ankesa.

**Rasim Fazliu** – I nderuari kryesues propozoj që pika e 8 dhe 9 të votohen në pako dhe të shkojnë përmbledhje të kuvendit, sepse kuvendi është ai i cili vendos, besoj se do më përkrahin edhe kolegët.

**Kryesuesi** – Të nderuar pasi jeni pro propozimit të z. Rasim Fazliu, i qes një nga një pikat në votim. Konstatoj se Propozim vendimi i kryetarit të komunës përmblidhet e komisionit përmblidhet e ankesave përmblidhet e emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit, kalon përmblidhet e kuvendit. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

#### **9. Shqyrtimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës përmblidhet e komisionit përmblidhet e emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit.**

**Kryesuesi** – Po ashtu konstatoj se Propozim vendimi i kryetarit të komunës përmblidhet e komisionit përmblidhet e emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **10. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit përmblidhet e vitit 2019.**

**Përparim Krasniqi** – Përshtendetje përmblidhet e gjithë të pranishmit, pasi zyrtarja përmblidhet e menaxhimin e mbeturinave është e zënë do ju prezantoj unë këtë informatë. Komuna e Rahovecit operon me dy operator, të cilët i kanë zonat e ndara, po ashtu ju informoj zyrtarisht se komuna e Rahovecit ka filluar me një plan përmblidhjen e mbeturinave përmblidhet e amvisëri në të gjitha rrugët dhe lagjet e qytetit, ky aksion ka filluar nga data 24 maj dhe do të mbaroj me 24 qershor. Do të kemi bashkëpunime me organizatat e huaja ndërkombëtare, ne jemi duke eliminuar të gjitha deponitë inertë që janë në komunën tonë, por përmblidhet e reshjeve të shumta që i kemi pasur në ditët e fundit është ndërrprerë ky aksion. Ne si komunë qëndrojmë mirë, të gjitha raportet që i kemi ne në nivelin qendrorë qëndrojmë mirë, një gabim i cili ka ndodhur vitin e kaluar përmblidhjen e mbeturinave, komuna jonë nuk është klasifikuar mirë, por këtë vite qëndrojmë mirë dhe jemi në vendin e katërt në nivel të Kosovës. Kaq përmblidhet e fillim nëse keni ndonjë pyetje jam këtu përmblidhet e ju përgjigjur.

**Dervish Çadraku** – Më intereson se këto kompani që i kanë bërë grumbullimin e mbeturinave nga anfisërit tona, pyetje ime është kur do të merë në menaxhim komuna këtë, pastaj a keni mundësi në përmblidhjen e ardhshme të na ofroni një raport mbi gjendjen faktike të komunës së Rahovecit pas të reshurave të shiut.

**Rasim Fazliu** – I nderuari drejtor ju falëndero shumë që na keni sjellë këtë informatë, por jam shumë i shqetësuar sepse me të vërtet është një material i shkruar me shumë gabime drejtshkrimore, po ashtu ka gabime edhe logjike sepse nuk janë fjalët e lidhura njëra me tjetrën. Prandaj propozoj që ky material të rishqyrtohet edhe një herë dhe të na vije përmblidhet e kuvend ashtu siç i ka hije një materiali zyrtar, sepse jemi institucion dhe nuk bënë dokumentet tona të përcillen do si do. Në faqe nr.2 e keni cekur: Ndërmarrja publike Eko Regioni e cila ofron pjesën më të madhe të territorit, mendoj se këtu duhet të ceket e cila e menaxhon pjesën më të madhe të territorit. Pastaj faqe nr.3 ceket: bashkë duhet të vetëdijesohemi se mbeturinat nuk kemi nevojë të i hudhim në ambientet e pastërtë, duhet të jetë t'i hedhim e jo ti hudhim sepse është trajta e shkurtër. Pastaj e keni cekur: Se sektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është përballur me plotë sfida përmblidhet e një kohë të gjatë e tanit. Nuk e di se çka keni dashur të thoni me fjalinë e fundit “e tanit”, propozoj që fjalia e tanit të eliminohet sepse nuk e ka vendin aty. Në faqe nr.4 ceket: komuna e ka përzgjedh deponin ku do të hedhen mbeturinat nga konstruktimi dhe demolomi, pyetje ime është se çka keni punuar në këtë drejtim deri tanit, a është punuar diçka. Pastaj tek numri i ekonomive familjare e keni cekur se numri i ekonomive familjare që marrin këtë shërbime është 8221, kurse më poshtë ceket se numri i përfshirë në menaxhimin e mbeturinave ekonomike familjare është 8607, pra me këtë i bie që ma shumë menaxhohen se sa që janë të evidentuara, kjo nuk është logjike. Kurse sa i përket bizneseve janë 797, në sistemin e mbeturinave mendohet se janë të regjistruarar rrëth 2000 biznese, pra kemi kontraste mjaftë të mëdha. Do të ndalem pak te gjenda ekzistuese në komunën e Rahovecit, tek fjalia e dytë ku ceket: Qëllimi i këtyre aktivitetave do të jetë mbi rendësin e ruajtjes së biodiversitetit (toka, uji dhe ajri etj). Kjo fjalë nuk e cakton tokën, ujin dhe ajrin, por fjalë diversitet nënkupton llojshmëri të botës bimore dhe shtazore që gjenden në tokë dhe ujë. Besoj se përmblidhet e kuvendit do i përmirësoni këtë informatë.

**Fehmi Cena** – Në Faqe nr.3 tek sfidat në menaxhimin e mbeturinave, aty janë edhe mbeturinat kimike, por më poshtë ceket: Mbeturinat elektronike të cilat nuk janë drejtpërsëdrejti në kompetencë të komunës, edhe pse në komunë tonë nuk kemi mbeturina kimike dhe elektronike. Shtrohet pyetje se çka janë mbeturinat kimike, besoj se janë mbeturinat e lëngshme që i bëjnë automekanikët si vajrat e ndryshëm, dhe mendoj se janë shumë shqetësuese sepse tek ne drejtpërsëdrejti po i derdhin nëpër ujërat e ndryshme. Ndotja nga këto është zakonisht e madhe, mendoj se bie ndesh me realitetin, prandaj duhet të keni kujdes që në mbledhjen e ardhshme të përmirësohen këto gabime.

**Fjolla Duraku** – E falënderoj drejtorin për sqarimet që na i dha rrith kësaj informate, dua të ndalem tek kompanitë që shërbejnë për konsumatorët shtëpiak, bizneset dhe institucionet, ku thuhet se bëhet shërbimi derë në derë dhe konsumatorët pajisen me kontejnerë. Desha të bëjë një kërkësë që rrugët dhe rrugicat të pajisen sa më shumë me këto kontejnerë në mënyrë që mbeturinat të mos hedhen vend e pa vend. Besoj se kjo është njëra nga arsyet pasi jo gjithnjë mbeturinat munden të i mbajnë në dorë për një orë rrugë, deri sa të gjendet ndonjë kontejner apo deri sa të shkojnë në shtëpi. për vete në Krushë të Madhe nuk është se shohë ndonjë kontejnerë rrugëve, përvëç atyre që janë të vendosur në shkollën fillore nga vetë shkolla.

**Përparim Krasniqi** – Ju falënderoj për pyetjet e bëra, së pari ju tregova se këtë raport e ka përgatitur znj. Bjondina Rama, por unë kam rapportuar për shkak të mos prezencës së sajë, sa i përket gabimeve teknike pajtohem plotësisht me ju, ka gabime teknike drejtshkrimore, besoj se për mbledhje të kuvendit do të përmirësohen këto gabime. Inderuari z. Çadraku sa i përket komisionit për vërvshime, komuna ka formuar komisioni dhe janë në teren ku janë duke i evidentuar dëmet, shpresojmë se nuk do të ketë më të reshura, por besoj se për mbledhje të kuvendit do të ofrojmë ndonjë raport sa i përket dëmeve që janë bërë në komunën e Rahovecit. E nderuar znj. Fjolla ne si komunë këtë vite e kemi fituar një grand prej 40 kontejnerë, ku i kemi shpërndarë shumicën në qytetin e Rahovecit, sidomos në rrugët kryesore të qytetit ku kanë qenë të dëmtuara kontejnerët, gjithsej në qytetin e Rahovecit janë 84 kontejnerë, ku 40 i kemi nderuar kurse edhe 40 tjerë kanë mbetur të vjetra. Kurse në fshatra kontejnerët e mëdhenj  $1^3$  i kemi ofruar vetëm në institucione, kurse nëpër shtëpi parashihet edhe me ligj që të eliminoohen kontejnerët e mëdhenj, si në fshatra ashtu edhe në qytet për arsyet se është duke u ndotur ambienti. Tani kërkohet që më shumë të ofrohen kontejnerë individual për çdo shtëpi. shpresojmë që të ritet buxheti sepse është një kosto goxha e madhe që të ofrojmë në të gjitha fshatrat dhe qytet kontejnerë për të gjitha familje. Inderuari z. Fazliu të gjitha çështjet që i ke ngritur do i trajtojmë me shumë kujdes. Kurse sa i përket mbeturinave kimie që i përmendi z. Cena, i nderuar këto trajtohen me ligjin për mbeturina, ku janë të cekur se cilat mbeturina janë kimike. Si mbeturina kime janë vajrat e kompanive të deriveve, të podrumeve që ndryshten quhen fenolët, kurse mbeturina industriale llogariten, akumulatorët e veturave, të cilat llogariten si mbeturina shumë të rrezikshme, kurse për mbeturina medicinale është një qendër në Prizren që është duke i trajtuar. Kurse sa i përket mbeturinave shtazore komuna jonë e ka një impiant të vogël dhe aty jemi duke i trajtuar, por ka mundësi që të dilet edhe jashtë kësaj nga njerëzit e pandërgjegjshëm.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit për debatin zhvilluar rrith pikë së dhjetë. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

### 1. Të ndryshme.

**Kryesuesi** – Të nderuar/a pasi nuk ka askush të shfoj diçka sa i përket kësaj pike, mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

**Mbledhja ka përfunduar në ora: 14:45**

Procesmbajtësi,  
Skender Hamza

